

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues - gjyqtarin Skender Çoçaj, me procesmbajtësen Birsën Kume - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve Feriz K. G. dhe R. G., që të dy nga Ferizaji, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 273 par.2 në lidhje me nenin 31 të KP-së, sipas aktakuzës së PTH në Prizren – PP/I.nr.241/2016 të datës 04.11.2016, në seancën e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Genc Nixha, të akuzuarit Feriz K. G. mbrojtësit të tij av. H. S. si dhe të akuzuarit R. G. dhe mbrojtësit të tij av. A. B., me datë 14.11.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## AKT GJYKIM

### Të akuzuarit:

**1.FERIZ K. G.**, nga i ati F. dhe e ëma N., e lindur A., i lindur me 27.09.1980 në Ferizaj ku edhe tani jeton..., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor fizik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në ndalim nga data 27.09.2016 nga ora 23,30.


**2.R. G.**, nga i ati A. dhe e ëma S., e ajzërisë F., i lindur me 05.10.1980 në Ferizaj ku edhe tani jeton..., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor fizik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në ndalim nga data 27.09.2016 nga ora 23,30.

### JANË FAJTOR

Se me datë 27.09.2016 me rastin e kalimit të kufirit Shqipëri-Kosovë në pikën kufitare të Vërmicës është vërtetuar se të njëjtit pa autorizim kanë poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca apo preparat të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, substanca psiko-trope apo analoge, në atë mënyrë që me rastin e kalimit të pikës doganore me veturën të markës "Golf" me targa..., të cilën e ka drejtuar F. K. ndërsa si pasagjer ka qenë R. G., me rastin e kontrollimit paraprak të automjetit në pjesën e përparme tek motori janë gjetur 2 pako të mbështjella si dhe nën karrigen e pasagjerit një pako tjetër për të cilat është dyshuar se janë substanca narkotike, me ç' rast me matjen e cila është kryer, është vërtetuar se sasia në fjalë është 1.995 gr. të cilat më pas janë konfiskuar nga ana e policisë së bashku me automjetin.

- Këso dore kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psiko-trope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 7, 17, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 75, nenin 273 par.2 -31 të KP-së, të akuzuarit i:



## G J Y K O N

### 1. I akuzuari F... K.

Me dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë apo nuk mundet ta paguajë, dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 (njëzetë) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim dhe,

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajve, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 27.09.2016 deri më datën 14.11.2016.

### 2. I akuzuari R. G.

Me dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro të cilën shumë I akuzuari obligohet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë apo nuk mundet ta paguajë, dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 (njëzetë) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim dhe,

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajve, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 27.09.2016 deri më datën 14.11.2016.


Në kuptim të nenit 273 par. 5 lidhur me nenin 69 par. 1 të KP konfiskohet sasia prej 1.995 gram marihuanë si dhe automjeti i markës "Golf" me targa të regjistrimit C...

Obligohen të akuzuarit që t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë në secili prej nga 100 (njëqind) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.241/2016 të datës 04.11.2016 kundër të akuzuarve F... K... dhe R... G..., që të dy nga Ferizaji, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psiko-trope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.2 në lidhje me nenin 31 të KP-së, si dhe ka paraqitur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Të akuzuarit F... K... dhe R... G... kanë pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 273 par.2 -31 të KP-së, e cila u vihet në barrë sipas aktakuzë.



Sa i përket gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar ashtu si është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës në kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë kështu që gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit F... K... dhe R... Grant... me datë 27.09.2016 me rastin e kalimit të kufirit Shqipëri-Kosovë në pikën kufitare të Vërmicës është vërtetuar se të njëjtit pa autorizim kanë poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca apo preparat të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, substanca psiko-trope apo analoge, në atë mënyrë që me rastin e kalimit të pikës doganore me veturën të markës "Golf" me targa ..., të cilën e ka drejtuar F... K... ndërsa si pasagjer ka qenë R... G..., me rastin e kontrollimit paraprak të automjetit në pjesën e përparme tek motori janë gjetur 2 pako të mbështjella si dhe nën karrigen e pasagjerit një pako tjetër për të cilat është dyshuar se janë substanca narkotike, me ç'rast me matjen e cila është kryer, është vërtetuar se sasia në fjalë është 1.995 gr. të cilat më pas janë konfiskuar nga ana e policisë së bashku me automjetin.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ku prokurori i shtetit ka propozuar që marrëveshja e arritur me të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre të aprovohet.

Prokurori i shtetit gjatë seancës ka propozuar që marrëveshja e arritur me të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre të aprovohet ashtu siç është paraqitur me shkrim.

Mbrojtësit të të akuzuarve kanë kërkuar që marrëveshja për pranimin e fajësisë të aprovohet nga gjykata.


Pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, si dhe të akuzuarit lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata konstatoi se të akuzuarit F... K... dhe R... Grant... kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre avokatët H... S... dhe A... B..., gjykata ka konstatuar se të akuzuarit në asnjë mënyrë nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar ta pranojnë fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat janë paraqitur në aktakuzë të pranuar edhe nga i akuzuari dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat që parashihen në dispozitat e nenit 253 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës.

Lidhur me dënimin prokurori i shtetit ka qëndruar pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe ka shtuar se pajtohet që gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parasysh dispozitat për zbutjen e dënimit duke pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre lidhur me dënimin kanë deklaruar se qëndrojnë pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë për çka edhe gjykata ka aplikuar dispozitën e nenit 75



paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 për zbutjen e denimit, gjithashtu gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve se të njëjtit janë të moshës së re, se në gjykim kanë pasur qëndrim tejet korrekt. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451 dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,  
P.nr. 196/2016 më datë 14.11.2016**

**Procesmbajtësja  
Birsen Kume**



**Kryetari i trupit gjykues  
Skender Çoçaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ndaj këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtën e ankesës për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa për bazat tjera mund të ushtrohet, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate